

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTER EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)

DHOMA KOMBETARE E NOTERËVE

ADRESA

RR.DESHMORET E 4 SHKURTIT  
PALLATI BLU PERBALLE  
GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI,  
KATI 2 TEL: 0694439947

DEGA VENDORE TIRANE

**KONTRATE DHURIMI PASURI E  
LUAJTSHME**

Nr. repertori: 4258

Nr. koleksioni: 1495

Tirane me 10/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, date 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale”, i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, date 20/12/2018 “Per Noterine ”

**\*Akti noterial perbehet nga 1 flete**



## Kontratë shit-blerje aksionesh

Sot më datë 10 /12/2020, u hartua dhe nënshkrua kjo kontratë midis palëve të mëposhtme:

**Cambridge Pathology B.V**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin holandez, adrese Nassaulaan 2 A, 2514JS' s-Gravenhage, Holandë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Dhomës së Tregtisë me numrin e dosjes 27304776,, këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**",

dhe

**Znj. Albana PRIFTAJ**, e bija e Kristaqit dhe Behijes, e datëlindjes 03.05.1976, lindur në Fier, Shqipëri banues në Rruga Panorama, Kompleksi Panorama, Shkalla 5 Ap. 20, Tiranë, Shqipëri, identifikuar me Letër Njoftimin nr. H65503053U, këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**",

Të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë për të lidhur kontratën e mëposhtme. Palët e mësipërme ranë dakord për përmbajtjen e kontratës ndërmjet tyre, si më poshtë vijon:

### Preambula:

*Duke qënë se Cambridge Pathology B.V, dëshiron të shesë 10% të kuotave të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë tregtare "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M01317022A;*

*Duke qënë se Znj. Albana PRIFTAJ dëshiron të blejë 10% të kuotave të kapitalit themeltar në shoqërinë tregtare "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M01317022A;*

*Duke qënë të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, si dhe në përmbushje të parashikimeve të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statutit të Shoqërisë Tregtare, "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK, palët e mësipërme vendosin të*

## Share Sale and Purchase Agreement

Today, on 10 / 12/2020, this contract was drafted and signed between the following parties:

**Cambridge Pathology B.V**, a limited liability company, established in accordance with Dutch law, address Nassaulaan 2 A, 2514JS 's-Gravenhage, Netherlands, registered in the Chamber of Commerce Registry with file number 27304776, hereinafter referred to as the "**the seller**",

and

**Mrs. Albana PRIFTAJ**, daughter of Kristaq and Behije, born on 03.05.1976, born in Fier, Albania, resident in "Panorama" Street, Panorama Complex, Entrance 5; Ap. 20, Tirana, Albania, identified by the Identification No.: H65503053U, hereinafter referred to as "**the Buyer**",

Who expressed their free will to enter into the following contract. The above parties agreed between them, on the content of the contract, as follows:

### Preamble:

*Whereas Cambridge Pathology B.V., wants to sell 10% the Founding Capital Quotas owned in "Cambridge Clinical Laboratories" LLC Trade Company, registered at the National Business Center with NUIS M01317022A;*

*Given that Mrs. Albana PRIFTAJ wants to buy 10% Founding Capital Quotas in "Cambridge Clinical Laboratories" LLC, Trade Company, registered in the National Business Center with NUIS M01317022A;*

*Aware of the importance of their actions, as well as in compliance with the provisions of the law "On Traders and Business Organizations" and the Statute of the Trade Company, "Cambridge Clinical Laboratories"*



*lidhin këtë kontratë në përputhje me kushtet si më poshtë.*

## **Neni 1 Kushtet e Kontratës**

- 1.1 Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.
- 1.2 Kontrata quhet e vlefshme meqenëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjellët vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.
- 1.3 Në këtë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkaku ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

## **Neni 2 Qëllimi i Kontratës**

- 2.1 Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë së 10% të aksioneve kundrejt pagesës së 10,00 (dhjetë) ALL, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK., që zotëron Shitësi, në favor të Blerësit.
- 2.2 Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.
- 2.3 Me anë të këtij veprimi juridik të dyanshëm, palët synojnë të krijojnë një marrëdhënie juridike ndërmjet tyre, e cila mbështetet në parimet e ndershmërisë, ligjshmërisë dhe besimit reciprok ndërmjet palëve.
- 2.4 Në përcaktimin e kushteve, Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, dhe angazhohen të kryejnë veprimet e tyre brenda

*LLC, the above parties decide to enter into this contract in accordance with the conditions as follows.*

## **Article 1 Terms of the Contract**

- 1.1 In the conclusion of this Contract there is the consent of the parties in assuming the respective obligations and liabilities, the legal cause on which the obligations are based, and the object that forms the subject of the contract.
- 1.2 The contract is considered valid as the parties have mutually expressed their mutual will, agreeing on all its essential terms.
- 1.3 In this Contract, the parties express and guarantee that the legal cause of its conclusion is not illegal, does not contradict the law, public order and the Contract does not serve as a means to avoid the implementation of a norm of Albanian legislation.

## **Article 2 Purpose of the Contract**

- 2.1 The purpose of this Contract is the transfer of ownership of 10% of the shares against the payment of 10.00 (ten) ALL, of the Founding Capital Quotas of "Cambridge Clinical Laboratories LLC" Trade Company, owned by the Seller, in favor of the Buyer.
- 2.2 This Contract serves to determine the criteria, procedures and ways of transfer of this property, as well as the relevant payments related to this transfer.
- 2.3 Through this bilateral legal action, the parties aim to establish a legal relationship between them, which is based on the principles of honesty, legality and mutual trust between the parties.



kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate.

### Neni 3 Objekti i Kontratës

3.1 Objekti i kësaj Kontrate është i mundshëm, i ligjshëm, dhe i përcaktueshëm nga Palët nëpërmjet kësaj Kontrate, si dhe konsiston në Kuotat e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK., kundrejt vlerës së shitjes së tyre.

3.2 Me anë të kësaj Kontrate, Shitësi detyrohet t'i japë dhe ti kalojë Blerësit 10% të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ai zotëron tek Shoqëria Tregtare "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK., kundrejt shpërblimit të caktuar në këtë Kontratë.

3.3 Blerësi merr përsipër t'i paguaj Shitësit respektivisht shumë prej 10,00 (dhjetë) Lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës, kundrejt transferimit të pronësisë së 10,00% të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ai zotëron në Shoqërinë "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK.

3.4 Si rezultat i kësaj Kontrate, Blerësi do të mund të ushtrojë të njëjtat të drejta në Shoqërinë "Cambridge Clinical Laboratories" SHPK., për të cilat ishte titullar Shitësi.

### Neni 4 Efektet e Kontratës

4.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës. Pagesa e sanksionuar në kontratë është paguar midis palëve cash.

4.2 Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

4.3 Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

### Neni 5

2.4 In determining the terms, the Parties in the contract freely determine its content, and undertake to carry out their actions within the limits set by the legislation in force and by the content of this contract.

### Article 3 Object of the Contract

3.1 The object of this Contract is possible, lawful, and determinable by the Parties through this Contract, and as it consists in the Founding Capital Quotas of "Cambridge Clinical Laboratories LLC", Trade Company versus the value of their sale.

3.2 Through this Contract, the Seller is obliged to give and transfer to the Buyer 10% of the Founding Capital Quotas that owns in "Cambridge Clinical Laboratories" LLC, Trading Company versus the remuneration specified in this Contract.

3.3 The Buyer undertakes to pay respectively the amount of 10,00 (ten) ALL to the Buyer, at the moment of signing the contract, versus the transfer of ownership of 10,00% of the Founding Capital Quotas that he owns in the "Cambridge Clinical Laboratories" LLC, Trade Company.

3.4 As a result of this Contract, the Buyer will be able to exercise the same rights in "Cambridge Clinical Laboratories" LLC Company, for which the Seller was the holder.

### Article 4 Effects of the Contract

4.1 This contract enters into force at the moment of signing the contract. The payment sanctioned in the contract is paid between the cash parties.

4.2 This contract has the force of law for the contracting parties.



## **Zgjidhja e Kontratës**

5.1. Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

## **Neni 6 Interpretimi i Kontratës**

6.1 Në rast se do të lindë e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

6.2 Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontratës

6.3 Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

## **Neni 7 Baza Ligjore**

7.1 Kontrata hartohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 8 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

8.1 Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

8.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

4.3 The contract has effect on third parties and other entities, as provided by law.

## **Article 5 Termination of the contract**

5.1. In cases when one of the contracting parties does not fulfill its obligations provided by this Contract, the other contracting party, as the case may be, may request the termination of the contract.

## **Article 6 The Interpretation of the Contract**

6.1 If it becomes necessary to interpret this Contract, then it will be clarified what is the true and common purpose of the parties, without stopping at the literary meaning of the words, as well as assessing their conduct as a whole, before and upon termination of the contract.

6.2 7.2. The terms of the Contract will be interpreted through each toward the other, giving each one the meaning that emerges from the entirety of the Act of the Contract

6.3 The contract must be interpreted in good faith by the parties.

## **Article 7 Legal basis**

7.1 The contract is drafted and interpreted according to the laws of the Republic of Albania.

## **Article 8 Dispute Resolution**

8.1 The seller and the buyer are committed to making every effort to resolve disputes or conflicts that have occurred between them or in connection with this Agreement, through direct negotiation.


8.2 If the parties fail to resolve the dispute or conflict between them, will be tried to assess the problems



8.3 Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10**  
**Dispozita të fundit**

10.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në tre kopje, dhe pas nënshkrimit të saj nga palët secila prej tyre merr nga një kopje, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri.

**Shitësi | Seller**  
Cambridge Pathology B.V.  
  
Tamara Wingelaar


by resolving the dispute under the contract and the legal procedures in force under the legislation of the Republic of Albania.

8.3 In case of judicial disputes, the competent Court will be the Judicial District Court, Tirana.

**Article 10**  
**Final provisions**

10.1 This agreement is compiled into three copies, and after its signing by the parties, each of them receives a copy, a copy is deposited in the National Registration Center, in Albania.

**Blerësi | The Buyer**

  
Znj. Albana Priftaj

NOTERE  
EDLIRA MALAJ (GALANYI)  
NIPT: L31322006A  
TEL: 042 451041








**REZULTATET E KERKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20200924124641678  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 10.12.2020  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 12:46:41PM  
Lloji i Kerkimit: MALLRA ME NUMER SERIE  
Numri i Dokumentit: D-400-574-932  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E MALLRAVE ME NUMER SERIE ME REZULTAT KERKIMI 0**

**CAMBRIDGE PATHOLOGY B.V**



*Auto Qra*